



**FJALA E PRESIDENTIT:**  
**FESTA E VERES E 14 KORRIKUT 2021**

**Te dashur miq,**

Jam vërtetë shumë i lumtur që festoj me ju sot **"Festën e 5-të të Verës"** në këtë ditë shumë të veçantë, **Festën Kombëtare Franceze**.

Ju uroj te gjithëve mireseardhjen në emrin tim e të Këshillit Drejtues!

Deshiroj te pershendes ne menyre te vecante te ftuarit tanë të Nderit:

**Zoti Kryeministër, Shkëlqesia e tij Edi Rama**

**Presidentja jonë e Nderit, Zonja Ambasadore e Francës, Shkëlqesia e saj Elisabeth Barsacq,**

**Zoti Peter Zingraf – Shkëlqesia e tij Ambasadori i Ambasades Gjermane ne Shqiperi**

**Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, Zoti Eduard Shalsi**

Gjithashtu dua të përshëndes të gjithë pjesëmarrësit dhe të falenderoj të ftuarit tanë, anëtarët e Dhomës sonë dhe të gjithë ju, Zonja dhe Zotërinj.

I uroj mirëseardhjen anëtarëve tanë të rinj: [CESI BTP](#), [Volitalia Albania](#), [YLLIAD SHPK](#), [Peugeot Albania](#), [Veizi cash & Carry](#) et « [Kantina Arberi](#)” dhe [Epitech Albania](#) »

**Faleminderit për besimin tuaj! Dhoma jonë do të jetë në dispozicionin tuaj!**

Të gjithë tashmë e dini që ambicia e Dhomës së Tregtisë Franceze është të **promovojë zhvillimin dhe suksesin e kompanive Franceze në Shqipëri dhe anasjelltas**.

Në fakt, kjo ambicie daton që nga viti **1922**; Kam kënaqësinë t'ju sjell disa informacione nga arkivat e mikut tim Armer JUKA; Dhe e pranoj që u befasova kur zbulova këto informacione.

Behet fjale per nje document original I hartuar ne Shkoder me 5 dhjetor 1922, nga Zoti Terenc TOCI, Drejtori i Zyrës së Shtypit i Prefektures se Shkodrës

Citoj: *"Gjeranti I Legates sone lajmeron se në sallën e Legates jane mbledhur një numër tregtarësh shqiptarë dhe francezë, ku vendosen te formojne nje Ode franceze e cila do te kete per qellim zhvillimin e marrëdhënieve tregtare midis dy shteteve".*



Imagjinoj se nuk ishte larg nga kjo ide francezi i famshëm **Justin (zhystË) GODARD**, një mik i madh i Shqipërisë, i cili e vizitonte shpesh vendin nga viti 1920 deri në 1930. Deputet, Senator, Ministër, themelues i ligës kundër kancerit dhe Kryetar i Bashkise se Lionit.

Kohët e fundit zbulova në arkivat familjare se ai ishte një mik i stërgjyshit tim, kryetarit të një komune afer Lionit me të cilin ndante një pasion për kuzhinën Lioneze, në veçanti për bretkosat nga rajoni i Domb.

Dua të përmend **vizitën e Kryeministrit Rama në 19 Qershor në Paris, shoqëruar nga Dhoma jonë**. Ndër të tjera, Kryeministri u takua me kompani si **Veolia dhe grupi Accor** i cili ka nënshkruar kontrata me Shqipërinë. Kryeministri dha intervista në TV "France 24" dhe për gazetën "Le Figaro" me qëllim **tërheqjen e kompanive** për të investuar në Shqipëri.

Prandaj jemi shumë të sigurve se shoqeri te tjera franceze do të ndjekin **suksesin e Voltalia-s**, e cila së fundmi ka fituar dy tendera për parqet foto voltaike në Karavasta dhe në Spitalë; një histori e vërtetë suksesi!

Për t'u rikthyer te Dhoma: Këtë vit ne kemi organizuar evente profesionale, online, për arsye që të gjithë i dimë tashmë; **Asambleja e 9-të e Përgjithshme**; aktivitetet gjatë muajit të Frankofonisë, **Webinaire « Regard Business »** me folës anëtarët tanë dhe të ftuar të tjerë;

Pas rikthimit në shtator, ne do të organizojmë seminarin **"Shkollimi i fëmijës tim në shkollën Franceze në Shqipëri"**. Ky seminar është shumë i dobishëm për ju prindër shqiptarë dhe franceze.

Gjithashtu, në vjeshtë, përveçse prej ndonje kufizimi për shkak të epidemise, presim një vizitë nga një **grup industrialistësh francezë** për të studiuar mundësinë e krijimit të kompanive franceze që dëshirojnë të riatdhesojnë në Europë produktet e zhvendosura në Kinë. Grupi do të drejtohet nga Z. **Jean Paul AGON**, si President i Këshillit (Shqipëri) i MEDEF INTERNATIONAL "

❖ Dua të përmend gjithashtu se një nga përparësitë e Dhomës është promovimi i produkteve të anëtarëve tanë, veçanërisht në newsletter:

- **France Albanie Express – 7** botime janë shpërndarë në rreth 5,000 kontakte në Shqipëri dhe në rrjetin CCI në Francë dhe ndërkombëtarisht, çdo muaj,
- **CCIFA Weekly News - 150** botime u shpërndanë anëtarëve dhe partnerëve tanë çdo të Premte

Si edhe **në faqen e internetit të CCIFA** dhe rrjetet tona sociale: **LinkedIn, Instagram, Facebook, Twitter**

**Një tjetër përparësi** është **Mbështetja për kompanitë franceze**, dhe mbrojtja e interesave të anëtarëve tanë kur ato pyeten nga një partner ose një autoritet!



**Një përparësi e tretë** është trajtimi dhe përcjellja e çështjeve tuaja tek Autoritetet Publike

- Kohët e fundit kemi punuar në temën jashtëzakonisht të rëndësishme të fiskalizimit të shoqërive;
- Për deklarimin e pronarëve në E-albania;
- Për strategjinë e investimeve 2001-2027 ;
- Për zhvillimin e strategjisë ligjore 2021-2023, etj

Dera ime është gjithmonë e hapur për të gjithë anëtarët tanë, veçanërisht në kohë të vështira.

Më mbetet vetëm t'ju uroj - ose më mirë të uroj **për të gjithë ne një behar të bukur!**

**Tani dua t'i jap fjalën Zonjës Ambasadores së Francës**

**Julien Roche**  
**President**

*B Traduction*